

KRIKË DHE BIBLIOGRAFI**YMER ÇIRAKU****“SANTORI – POET DHE DRAMATURG”,
STUDIM MONOGRAFIK NGA KLARA KODRA**

(Botuar nga Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) & Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2022)

Serisë së botimeve mbi letërsinë e kulturën arbëreshe, krahas disa botimeve të tjera nga QSPA, iu shtua kohët e fundit edhe studimi i gjerë monografik “*Santori, poet dhe dramaturg*”, me autore studiuesen e njohur të letërsisë arbëreshe, Klara Kodra.

Bota arbëreshe mbetet një thesar i çmuar, prej së cilës historia dhe kultura shqiptare, është ushqyer e pasuruar përgjatë shekujve e në vazhdim. Tërë ky kontribut i shtrirë në fusha të ndryshme, duhet thënë se në pjesën më të madhe të tij, mbetet ende i panjohur nëpër fondet e seminareve arbëreshe, të kishave, në shumë arkiva familjare e në biblioteka të qyteteve të Italisë e të vendeve të tjera. Sado që jo pak prej tyre, tashmë janë bërë objekt studimesh të thelluara nga studiues shqiptarë e albanologë të huaj, e sidomos nga studiuesit arbëreshë, mbetet gjithsesi një pjesë e madhe e tyre, thesar ende i pazbuluar e i pastudiuar sa duhet.

Edhe në këtë studim mbi krijimtarinë letrare të Françesk A. Santorit (1819 – 1894), K. Kodra me të drejtë e shqyrton personalitetin e tij në një prirje rivlerësimi. Vërtet për të është shkruar edhe më parë, është vlerësuar kontributi si autor i dramës së parë shqipe “Emira”, i tragjedisë së pabotuar “Neomenia”, i disa melodramave, si dhe ka qenë i përfshirë prej vitesh në tekste shkollore dhe ato akademike. Por kërkimet dhe zbulimet mbi shumë vepra në dorëshkrim dhe disa vepra të botuara – por që deri më sot rezulton të mos gjenden më kopje të tyre, sigurisht që krijojnë premisat për ta parë në një vështrim të ri këtë figurë. E pse jo, për t’iu larguar mbase stereotipeve për ravijëzimin e tij si autor pothuaj “minor”.

Autorja e studimit, duke renditur argumentet përkatëse, hedh pikëpamjen se Santori është një shkrimtar, që me krijimtarinë e tij, zhvendoset gradualisht nga periferia drejt qendrës, për shkak të rolit të tij prej nismëtari, themelues dhe lëvruar i gjinive dhe llojeve të reja letrare, si dhe për shkak të teknikave të reja formale, me të cilat ai e pasuroi letërsinë arbëreshe. Sidomos vlerësohet

muzikaliteti në poezinë e Santorit, që është i lidhur ngushtë me atë rrymë të nëndheshme lirizmi e që i shton freskinë kësaj poezie.

Në këtë monografi, autorja ndalet kryesisht në lëvrimin e poezisë, si dhe pjesëve të ndryshme dramatike (drama, melodrama, komedi) në vargje, duke bërë me dije se në një botim tjetër të pritshëm studimor të saj – do të bëhet i njohur për lexuesin lëvrimi i romanit nga Santori, pra, “romancetat” (romanet e shkurtër) apo romanet në vargje.

Në studim, vërehet puna e ngulët hulumtuese e kësaj autoreje nëpër fonde bibliotekash dhe arkivash, për t’u njohur me dorëshkrime e botime të hershme veprash të autorit, duke synuar që t’ua heqë atyre pluhurin e kohës dhe t’i bëjë pastaj, pjesë të vlerësimit nga opinioni letrar. Sigurisht, që kjo punë do të ndihmonte që të sensibilizojë edhe mundësinë e botimit të pritshëm të disa prej tyre - në një kohë të volitshme - për t’i bërë kështu ato, pjesë të fondit aktiv të leximit.

Shpалosja e këtij kontributi të pasur letrar të Santorit, në studimin e K. Kodrës, nuk ndjek thjesht një përshkrim linear të rrethanave, sipas rastit: të shkrimit të veprave, të gjetjes e botimit të tyre, pastaj të opinionit letrar të kohës dhe opinionit letrar të sotëm mbi to. Autorja, këto kontribute i analizon përmes gjykimit të saj kritik, duke mbështetur apo dhe duke polemizuar me teza e pikëpamje të ndryshme, që janë hedhur nëpër kohë të ndryshme rreth krijimtarisë santoriane.

Gjykojmë se janë me interes, sidomos vlerësimet rreth dramës së mirënjohur “*Emira*”. Për këtë dramë është shkruar shumë, duke patur parasysh se ajo është bërë jo pak e njohur si tekst letrar, është botuar edhe në Shqipëri, në Kosovë e në Maqedoninë e Veriut. Përveç analizës që i bëhet poetikës së veprës, sidomos disa regjistrave të saj stilistikë, këtu jepet edhe atmosfera e pikëpamjeve të larmishme, shpesh edhe kontradiktore mes tyre. Kështu për shembull, jepet dilema nëse te kjo vepër, ka apo jo frymë tragjizmi, apo nëse kjo vepër, për nga struktura e saj e brendshme, më shumë ngjan t’i afrohet një romani sesa një krijimi dramatik. Apo diku tjetër në studim, duke debatuar me një tezë, sipas së cilës, vepra ka një fund të “hapur”, e përcaktuar kjo si shenjë e dukshme risie dhe moderniteti, por që studiuesja mendon se në fakt, fundi në vepër është qartazi i “mbyllur”, pasi ai shënon edhe mbylljen e konflikteve të ngritura nëpër pjesët skenike.

Në studim, vërehet se ka një lëndë të pasur veprash të shqyrtuara, por këto nuk mbeten thjesht në një renditje inventarizuese. Ato përcillen me vlerat e tyre specifike, por edhe brenda qarkores që ndjek tërë kjo krijimtari, brenda disa tipareve estetike.

Janë me interes disa teza të hedhura. Njëra prej tyre është ajo që ka të bëjë me kalimin e kësaj krijimtarie nga romantizmi drejt realizmit. Madje këto tipare, shihen të lidhura sa me specifikat e botës autentike arbëreshe, aq edhe me ndikimet natyrshëm prej botës kulturore e letrare italiane, duke arritur të

konsiderohen deri te ndikimet, që përcillen këtu prej rrymës së njohur të *verizmit* italian. Këto teza e të tjera, autorja e studimit i ka shtjelluar nëpër çështje apo argument të veçanta si: “*A qe Santori realist?*”, “*Santori dhe letërsia italiane*” etj.

Autorja vlerëson edhe kontributet e studiuesve të tjerë, të cilët janë marrë me krijimtarinë e A. Santorit, sidomos me poezinë e tij si: Giuseppe Gradilone, Italo Fortino, Rexhep Qosja etj. Pikëpamje dhe arritje të studimeve të tyre, janë përfshirë sipas rastit në rrjedhë të parashtrimit të tezave e debatit letrar. Ajo vlerëson dhe i është mirënjohëse edhe punës me akribi shkencore për transkriptimin e dorëshkrimeve të Santorit, realizuar nga studiues të mirënjohur si: F. Altimari, V. Belmonte, G. Belluscio.

Brenda librit, është përfshirë gjithashtu një bibliografi e veprave të Santorit, si dhe e studimeve mbi veprën e tij. Krahas tyre, zë vend edhe treguesi i emrave të personave, i personazheve letrare e i vendeve të përmendura brenda dhe rreth krijimtarisë së këtij shkrimtari arbëresh. Prania e tyre, u krijon lexuesve të interesuar e sidomos studiuesve, mundësinë për ta patur më të lehtë ndjen e tyre në universin e këtij autori arbëresh.

Sikundër shkruan në hyrje të studimit autorja K. Kodra, F. Santori është nga autorët më fatkeqë për sa i takon botimit dhe komunikimit të veprës së tij me lexuesin. Por duhet shtuar ndërkaq, se studime si ky, ashtu si dhe studime të tjera të botuara e të pritshme rreth kësaj figure, po e largojnë përfundimisht këtë situatë të pafavorshme të jetës së tij letrare.

